



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më . . 2022

MENDIM ME SHKRIM

Për gjykimin në seancë plenare të çështjes me:

KËRKUES:

Dhoma Kombëtare e Avokatisë

SUBJEKT I INTERESUAR:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

OBJEKTI:

Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e RSH të:
Nenet 10, pika 8, fjalë e dytë, në ligjin nr. 32/2021 “Për
sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”

BAZA LIGJORE:

Nenet 11, 17, 18, 131/c, 134, 155 të Kushtetutës së
Republikës së Shqipërisë,
Neni 3 dhe 14 i protokollit nr. 1 të KEDNJ,
Nenet 49, 50, 51 të Ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të
R.Sh”, ndryshuar me ligjin nr.99/2016 dhe ligjin nr.45/2021.

PËRPARA
GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

E nderuar Kryetare e Gjykatës Kushtetuese,
Të nderuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese,

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratimin e ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Kërkuesi ka depozituar pranë Gjykatës Kushtetuese kërkesën me objekt :

Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e RSH të:

Nenit 10, pika 8, fjalia e dytë, me këtë përmbajtje: “Pala e dëmtuar ose përfituesi, në rast se merr shërbime nga mbrojtësi ligjor, mund të paguajë deri 5% të vlerës së dëmshpërblimit të përfituar, por jo më pak se tarifat e përcaktuaranë aktet përkatëse.

Në vijim të shkresës Tuaj Nr. 530/4 Prot datë 20.09.2022 “Kërkim mendimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Komisioneri), paraqet **mendimin e tij në përputhje** me ;

- statusin e institucionit të pavarur publik;
- të attributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe
- në përmbushje të qëllimit për garantimin e të drejtës së çdo personi për barazi përpara ligjit.

I. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM DHE AKTET NDËRKOMBËTARE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹

Neni 14

Ndalimi i diskriminimit Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Protokolli Nr. 12

Neni 1

¹ Ratifikuar me ligjin Nr.8137, datë 31.7.1996 FZ. 20-1996

Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Ligj Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3

Përkufizimet

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Neni 6

Trajtimi i ndryshëm i përligjur

1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 21

Komisioneri

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, më poshtë komisioneri, siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri është person juridik publik.

Neni 22

Statusi

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32

Kompetencat

1. Komisioneri ka kompetencë:

gj) me kërkesën e gjykatës që shqyrton çështjen, të parashtrojë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;

II MENDIM

Për të trajtuar drejt pretendimin e kërkuarit në lidhje me nenin 10, pika 8, të ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në kuptim të ngritjes së kuptueshmërisë së tij në nivelin kushtetues, do parashatrojmë në mënyrë të përgjithshme duke evidentuar gjatë analizës pretendimin në lidhje me cënimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në referim të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se, të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa, paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive (*shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Konkretisht, ajo është shprehur se:

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”,

si dhe

“Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”

(shih vendimet nr.34, datë 20.12.2005; nr.39, datë 16.10.2007; nr.4, datë 12.02.2010,të Gjykatës Kushtetuese).

Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ-së përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik.

GJEDNJ-ja ka konfirmuar se, nocionet e diskriminimit të ndaluara, si nga neni 14 i Konventës ashtu edhe nga neni 1, i Protokollit Nr. 12, duhet të interpretohen në të njëjtën mënyrë².

Jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar disa standarde për të vlerësuar nëse një ligj apo një nen i tij, është diskriminues bazuar në kushtet dhe kriteret e nenit 18 të Kushtetutës. Në të tilla raste ajo që do duhej të konsiderohej është nëse ligji parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe, nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive.

Neni 14, i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim se çfarë përbën diskriminim.

Në praktikën e saj GJEDNJ-ja ka interpretuar se, "*diskriminimi i drejtpërdrejtë*" përshkruan një "ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge ose të ngjashme" dhe "bazuar në një karakteristikë të identifikueshme ose "status"³ të mbrojtur nga neni 14 i KEDNJ –së⁴. Pra, kërkohet që, personat në një situatë të ngjashme të trajtohen në mënyrë të barabartë⁵.

GJEDNJ rrallë e përdor termin "diskriminim i tërthortë". Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e

² Shiko : *Pilav kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, 2016, prg. 40; *Zornić kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, 2014, prg 27; *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës* [GC], 2009, prg. 55-56.

³ Shiko: *Biao kundër Danimarkës* [GC], 2016, prg 89; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], 2010, prg. 61; *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC], 2007, prg. 175; *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], 2008, prg. 60.

⁴ Shiko: *Varnas kundër Lituanisë*, 2013, prg. 106; *Hoogendijk kundër Holandës*, 2005.

⁵ Si më sipër.

ndryshme⁶. GJEDNJ-ja në praktikën e saj ka konstatuar se, diskriminimi i tërthortë mund të marrë formën e efekteve të dëmshme disproporcionale të një politike ose mase të përgjithshme, e cila, edhe pse e shprehur në terma neutralë, ka një efekt të veçantë diskriminues për një grup të caktuar⁷.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane

“Parimi i barazisë nuk lejon që të njëjtat t’i trajtosh ndryshe dhe të ndryshmet në thelb t’i trajtosh njësoj. Parimisht është në diskrecionin e ligjvënësit që të zgjedhë se cilat rrethana do të kenë pasoja juridike të njëjta me qëllim që t’i rregullojë ato njësoj nga pikëpamja juridike. Por këtë zgjedhje ligjvënësi duhet ta argumentojë në mënyrë të arsyeshme (BVerfGE 53, 313 (329)).

Fakti nëse në raste të caktuara është respektuar apo jo ne thelb parimi i barazisë, nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por duhet të shihet ne lidhje me veçoritë dhe karakteristikat e çështjes konkrete që synohet të rregullohet.”

(vendimi (Beschluss) i Senatit të Dytë, datë 09.03.1994 – 2 BvL 43, 51, 63, 64, 70, 80/92, 2 BvR 2031/92).

Për një kuptueshmëri më të mirë të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit legjislatori ka miratuar Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ku ndër të tjera parashikohen e dhe format e diskriminimit, të cilat në thelb janë forma të tipizuara sjelljeje që shkaktojnë cenim të parimit të barazisë dhe të mosdiskriminimit.

Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, e konkretizon nenin¹⁸ të Kushtetutës dhe është hartuar nën frymën e tij. Gjithashtu ky ligj është përfaruar plotësisht me standartet e Bashkimit Europian, konkretisht me katër Direktiva në këtë fushë⁸.

⁶ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

⁷Shiko: *Biao kundër Danimarkës* [GC], 2016, prg. 103; *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC], 2007, prg. 184; *Sampanis dhe të tjerët kundër Greqisë*, 2008, prg. 67)

⁸ Ligji është përfaruar plotësisht me:

1. 32000L0043, Direktivën e Këshillit 2000/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”.

2. 32000L0078, Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo-shteruese shkaqesh⁹.

Neni 14, i KEDNJ-së, garanton mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Shkaqet e cituara shprehimisht në këtë dispozitë të KEDNJ-së (Neni 14) janë ilustruese dhe jo shteruese.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "*status*", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.¹⁰ Gjykata ka theksuar se fjalës "*shkak/status tjetër*" në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.¹¹ Interpretimi i këtij nocioni "*nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme*"¹².

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të "*statuseve të tjera*" janë: Në *Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta*, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në *gradën ushtarake* mund të binte në kundërshtim me nenin 14; në *Larkos kundër Qipros*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një *dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër*; në *Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konsideroi se të qenit i *burgosur* mund të binte në nocionin e "*statusit tjetër*" sipas nenit

3. 32004L0113, Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime".

4. 32006L0054, Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".

⁹Në nenin 1 parashikohet shprehimisht "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

¹⁰ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

¹¹ Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

¹² Shih: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

14; në *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e "statusit tjetër", por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se *statusi si ish oficer i KGB-së* përfshihet në nenin 14; në *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e lirimit të parakohshëm bazuar në *kohëzgjatjen e dënimit me burg*.

Në çështjen *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar* (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: "Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive".

Në këtë kontekst përligjet kuptimi i barazisë, sipas të cilit: duhen trajtuar në mënyrë të ndryshme situata të ndryshme. Në të kundërt, nëse trajtohen në mënyrë të njëjtë situata thelbësisht të ndryshme atëherë jo vetëm që parimi i barazisë thelbësore nuk konkretizohet, por edhe parimi i barazisë formale mbetet i parealizuar.

Pikërisht nën dritën e këtyre standarteve, Komisioneri jep mendimin e tij sa i përket pretendimit për cënimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Norma e kundërshtuar si antikushtetuese nga kërkuesi, neni 10, pika 8, fjalë e dytë, e ligjit nr. 32/2021 "*Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit*", parashikon:

Pala e dëmtuar ose përfituesi, në rast se merr shërbime nga mbrojtësi ligjor, mund të paguajë deri 5% të vlerës së dëmshpërblimit të përfituar, por jo më pak se tarifat e përcaktuara në aktet përkatëse.

Norma e sipërcituar, në fakt normon një mardhënie e cila deri në momentin e hyrjes në fuqi, rregullohej nga Ligji 9109 datë 17.07.2003, ndryshuar me ligjin nr.9795 datë 23.07.2007 dhe ligjin nr.10 047, fatë 24.12.2008 "*Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë*". Ky ligj rregullon organizimin e profesionit të avokatisë, të drejtat dhe detyrat e avokatit si dhe kushtet për ushtrimin e këtij profesioni. Konkretisht :

Neni 11 (Shtuar pika 3 me ligjin nr. 91/2012, datë 27.9.2012) parashikon

1. Shpërblimi i avokatit për punën e kryer caktohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) me marrëveshje ndërmjet tij dhe palës së mbrojtjur ose të përfaqësuar prej tij;
- b) nga gjykata ose prokuroria, kur ai është caktuar kryesisht ose kur personi i mbrojtur ose i përfaqësuar nuk ka mundësi financiare dhe ndihma ligjore për të është falas.

Masa e shpërblimit për këto raste përcaktohet me vendim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

c) me ligj.

2. Në të gjitha rastet, avokatit nuk i lejohet të marrë shpërblim tjetër.

3. Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, pasi marrin mendimin e Ministrisë së Financave, caktojnë tarifat e shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike, të cilat zbatohen kur nuk ka marrëveshje të ndryshme me shkrim mes avokatit dhe personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij dhe kur ndihma juridike nuk është dhënë sipas dispozitave për ndihmën juridike.

Neni 12 parashikon

1. Avokati nuk mund të kërkojë nga personi që mbron ose përfaqëson, që të shpërblehet prej tij me përqindje gjatë procesit të gjykimit.

2. Shpërblimi me përqindje, i parallogaritur ose jo, mund të paguhet vetëm kur është parashikuar në marrëveshjen ndërmjet avokatit dhe personit që ai mbron ose përfaqëson, për rastin mbrojtjes apo përfaqësimit të suksesshëm të çështjes.

3. Avokatit i lejohet të paguhet me komision në rastet kur siguron kthimin e huasë për personin që mbrohet ose përfaqësohet prej tij jogjyqësisht.

Sikurse dispozitat parashikojnë qartazi, shpërblimi i avokatit për punën e kryer caktohet me :

- **marrëveshje,**
- **me ligj,**
- **nga gjykata ose prokuroria.**

Shpërblimi me përqindje, ka vetëm një kufizim. **Ai duhet të parashikohet në marrëveshjen** ndërmjet avokatit dhe personit që ai mbron ose përfaqëson, për rastin mbrojtjes apo përfaqësimit të suksesshëm të çështjes. Dispozita nuk referon kufizime në raport me masën e përqindjes së vendosur mes avokatit dhe klientit të tij. Kjo do të thotë se në të gjitha përfaqësimet, kur avokati nënshkruan një marrëveshje me klientin e tij, për përfaqësimin e çështjes, **masa e shpërblimit i nënshtrohet vullnetit të palëve kontraktore.**

Me hyrjen në fuqi të normës së atakuar, nëpërmjet një ligji i cili ka si objekt rregullimin e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, konstatohet se, vendoset një kriter i posaçëm i cili rregullon marrëdhënien mes avokatit dhe klientit të tij, **vetëm për përfaqësimin ligjor të një lloji çështjeje, e cila ka të bëjë me kontratën e sigurimit të mjeteve motorike.** Ky kriter nuk lejon mbrojtësin ligjor apo avokatin të përcaktojnë me marrëveshje me klientët e tyre, shpërblime të cilat kalojnë shumën 5%.

Në kushtet kur rregullimi i ri ligjor, parashikon një diferencim përsa i përket masës së shpërblimit të avokatëve, duke tejkaluar kompetencat e dhëna nga Ligji 9109, krijohet dyshimi i arsyeshëm se *prima facie*, rregullimi i ri ligjor vendos në pozitë më pak të favorshme përsa i përket masës së shpërblimit, avokatët të cilët përfaqësojnë çështje të cilat kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit të mjeteve motorike, në raport me avokatët të cilët përfaqësojnë çdo lloj çështje tjetër. Ky tejkallim është reflektuar me miratimin e dispozitës që përcakton kufirin deri 5% të vlerës së dëmshpërblimit të përfituar nga avokati apo ndihmësi ligjor.

Parimi i barazisë nënkupton:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin (neni 2 i Ligjit).

Referuar kësaj dispozite, koncepti i barazisë substanciale përbëhet nga dy aspekte:

“barazia e mundësive” dhe “barazia e rezultateve”.

Respektimi i parimit të barazisë kërkon ndër të tjera, mosdiskriminimin e shtetasve dhe grupeve, në kushte të njëjta, pa arsye të përligjura.

Diferenca në trajtim qëndron në faktin se një personi apo grupi personash u krijohen vështirësi apo u bëhet e pamundur ushtrimi i të drejtave dhe lirive të njohura, në raport me të tjerët, kur të gjithë këta persona janë ndodhur në rrethana të njëjta apo të ngjashme.

Për të qënë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të ligjit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, të njëkohshme këto kushte:

- të ekzistojë trajtim i diferencuar , i pabarabartë dhe i pafavorshëm, i personit në raport me të tjerët të cilët ndodhen në rrethana të njëjta;
- trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apo pamundësinë e këtij personi për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara, apo ligjet në fuqi.

KEDNJ-ja nuk garanton të drejtën për punë dhe profesion. Në praktikën e saj GJEDNJ-ja ka interpretuar se, meqenëse neni 8 garanton të drejtën për një "*jetë private shoqërore*"¹³, kjo dispozitë, në rrethana të caktuara, mund të përfshijë aktivitete profesionale dhe aktivitete tregtare¹⁴. GJEDNJ-ja ka interpretuar se ka disa aspekte tipike të "*jetës private*" që mund të preken në mosmarrëveshje të tilla nga shkarkimi, ulja në detyrë, mospranimi në një profesion ose masa të tjera të ngjashme të pafavorshme.¹⁵

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, në Rekomandimin nr.R(2000) 21 "*Për Lirinë e ushtrimit të Profesionit të Avokatit*", thekson, midis të tjerave, se duhen marrë të gjitha masat e nevojshme për të respektuar, mbrojtur dhe promovuar lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatit pa diskriminim dhe pa ndërhyrje të papërshtatshme nga autoritetet shtetërore; vendimet që kanë të bëjnë me autorizimin për të praktikuar si avokat ose për të hyrë në këtë profesion duhet të merren

¹³ Termi në gjuhën angleze "*private social life*".

¹⁴ Shih: *Fernández Martínez kundër Spanjës [GC]*, prg. 110; *Satakunnan Markkinapörssi Oy and Satamedia Oy v. Finland [GC]*, prg. 130.

¹⁵ Shih: *Denisov kundër Ukrainës [GC]*, prg. 101, 104-105, 108 dhe 109, 115-117; shih gjithashtu *J.B. dhe të tjerët kundër Hungarisë*, prg. 127-129.

nga një organ i pavarur; dhomat e avokatisë ose shoqatat e tjera profesionale të avokatëve duhet të hartojnë standardet profesionale dhe kodet e etikës; dhomat e avokatisë dhe shoqatat e tjera profesionale duhet të jenë organe të vetërregulluara dhe të pavarura, të afta të përfaqësojnë interesat e avokatëve, të promovojnë edukimin dhe trajnimin e tyre të vazhdueshëm dhe të mbrojnë integritetin e tyre profesional.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi.

Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj.

Sipas doktrinës, praktikimi i një profesioni mund të kufizohet nga rregullime të arsyeshme që mund t'u atribuohen konsideratave të së mirës së përgjithshme.

Parimi i Proporcionalitetit tashmë ka një përmbajtje të qartë. Ai është pasuruar mjaft edhe si rezultat i doktrinës gjyqësore, duke krijuar një përmbajtje të plotë në të gjithë elementët përbërës: qëllimi i legjitimuar, domosdoshmëria, testi i balancës së masave të marra.

GJEDNJ-ja, në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar apo dështimi për të trajtuar ndryshe persona të cilët janë në situata të ndryshme është diskriminues, nëse ai nuk bazohet në një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁶.

Sa më sipër, kur vendos për rastet e diskriminimit, GJEDNJ-ja do të zbatojë testin e mëposhtëm:

¹⁶ ¹⁶ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

1. A ka pasur ndonjë diferencë në trajtimin e personave që janë në situata të njëjta ose të ngjashme, apo dështim për të trajtuar ndryshe persona që janë në situata të ndryshme?
2. Nëse po, a është e justifikuar objektivisht një diferencë e tillë – apo mungesa e dallimit?
Veçanërisht, në lidhje me:
 - a. A ndjek një qëllim legjitim?
 - b. A janë mjetet e përdorura në mënyrë të arsyeshme, proporcionale me qëllimin e ndjekur?¹⁷

Për të përcaktuar nëse trajtimi i ndryshëm është proporcional, gjykata duhet të bindet se:

- Nuk ka asnjë mjet tjetër për arritjen e qëllimit që kërkon më pak ndërhyrje në të drejtën për trajtim të barabartë. E thënë ndryshe, që disavantazhi i pësuar të jetë minimumi i mundshëm i dëmit të nevojshëm për arritjen e qëllimit të synuar;
- Qëllimi për tu arritur është kaq i rëndësishëm saqë justifikon këtë nivel ndërhyrjeje.

Relacioni shoqërues i ligjit, nuk referon asnjë shpjegim në lidhje me arsyen dhe qëllimin që kërkon të arrijë me vendosjen e kësaj dispozite e cila vendos një kufizim sa i përket shpërblimit të avokateve apo mbrojtësve ligjorë, për çështjet të cilat kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit të mjeteve motorrike.

Në thelb, edhe pse legjislatori ka rregulluar me ligj të posaçëm një marrëdhënië juridike që lidhet me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, marrëdhënia e përfaqësimit midis një personi dhe një mbrojtësi ligjor në çështjet e sigurimit të detyrueshëm dhe në të gjitha çështjet e tjera të juridiksionit civil, mbetet e njejtë. Në këtë kontekst, nuk kuptohet dhe nuk shikohen justifikime se pse mbrojtësit ligjorë në këto çështje duhet të kenë një kufizim të lirisë së tyre për të vendosur mbi marrëdhënien financiare që duan të ndërtojnë me të dëmtuarin ose palën përfituese.

¹⁷ Referuar : *Guide on Article 14 of the European Convention on Human Rights and on Article 1 of Protocol No. 12 to the Convention*, përditësuar në 31 gusht 2022, botim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, fq.16. (në gjuhën angleze)

Theksojmë se, pikërisht se bëhet fjalë për një kufizim të një profesioni të lirë, në një natyrë të caktuar çështjesh, të rregulluar me ligj të posaçëm, arsyetimi dhe shpjegimi i kufizimit në relacionin përkatës është një domosdoshmëri, pasi vetëm kështu mund të kuptohet nëse ka apo jo një përligje të arsyeshme dhe objektive, që ndjek një qëllim legjitim nëpërmjet mjeteve proporcionale. Mungesa e një arsyetimi të tillë ngre dyshime të arsyeshme mbi respektimin e parimit të barazisë së kësaj norme e për rrjedhojë përputhshmërinë e saj me Kushtetutën.

Përfundimisht, parimet e mosdiskriminimit dhe të barazisë, janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situatat e barabarta të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situatat e pabarabarta ndryshe. Dështimi për ta bërë këtë do të përbëjë diskriminim, nëse nuk ekziston një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm¹⁸.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin Tuaj,

Me konsideratë,

K O M I S I O N E R I

ROBERT GAJDA

¹⁸ Referuar: *Explanatory Report to the Protocol No. 12 to the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms*, faqe 3.